



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 46/3 prot.

Elbasan, më 29.1.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**


Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.130 datë 29.12.2023 “Për dhënie në përdorim të hapësirave publike për përdorim të pikave të shërbimit (kioska) për tregtimin e mallrave të ndryshëm, shtypit dhe/ose kinkalerive”, si dhe pasi u njohëm me të dhënat sqaruese, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

Sugjerojmë që bashkia të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje në zbatim të VKM-së nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, ku të përcaktohen rregullat dhe procedurat e shfrytëzimit të hapësirës publike në territorin e bashkisë tuaj.

**PREFEKTI**



**Majlinda PERRIU**





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.01.2024

Nr. 34/ prot

Nr.130 dt.29.12.2023

**“Për dhënie në përdorim të Hapësirave publike për përdorim të Pikave të Shërbimit (Kioska) për tregtimin e mallrave te ndryshem shtypit dhe /ose kinkalerive.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 , pika 1/1.1, shkronja “a” dhe “b”, nenit 23, pika 14 dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Veteqeverisjen vendore”; Ligjit Nr.44/2015, datë 17.12.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4/1 të Ligjit nr.107/2017, datë 31.07.2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e teritorit”(i ndryshuar); Ligjit nr.8224 datë 15.05.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar); nenit 10,11,15 dhe 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1096, datë 28.12.2015 per “Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, bazuar në kompetencat ligjore dhe funksionet Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 29.12.2023 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhënien në përdorim të hapësirave publike për përdorim të pikave të shërbimit (kioska) për tregtimin e shtypit dhe /ose kinkalerive sipas projektit/skices bashkengjitur;
2. Afati I dhënies në përdorim të jetë 7 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit te Territorit ku harton planin për zënie e hapësirës publike, përcakton zonën, sipërfaqen, dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit, Sekretari I Pergjithshem , bazuar në planin e hartuar, nënshkruan kontratat e hartuara nga Sektori Juridik me subjektet që kanë paraqitur kërkesën, Drejtoria e Taksave Vendore faturon, monitoron dhe ndjek shlyerjen e detyrimit. Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë, se bashku me taksat e tarifat vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT  
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT  
Mitar BICAKU



